



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2, Tiranë

Tel. 04 268142; Fax 04268141

Nr. 675 Prot.

Tiranë, më 05 . 10 . 2015

V E N D I M

Nr. 108 , datë 05 / 10 / 2015

"Për një shtesë në Vendimin Nr.19, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil"

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me Vendimin Nr. 19, datë 11.03.2015, "Për miratimin e planit vjetor të punës të institucionit", ka miratuar planifikimin vjetor të procesit të mbikëqyrjes, duke përcaktuar subjektet që do të kontrollohen gjatë këtij viti, si dhe objektin e mbikëqyrjes.

Ndërkohë, duke pasur parasysh faktin se, procesi i rekrutimit në institucionet e administratës shtetërore, është i përqëndruar dhe kryhet nga Departamenti i Administratës Publike, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, nëpërmjet mbikëqyrjeve të planifikuara në këto institucione dhe të zhvilluara deri në këtë fazë të realizimit të planit vjetor të punës, nuk ka mundur që të mbledhë informacionin e nevojshëm në lidhje me funksionimin e institutit të pranimit në shërbimin civil, si dhe të ecurisë së sistemit të karrierës në shërbimin civil.

Në këto rrethana, si dhe duke marrë parasysh rëndësinë e madhe që ka procesi i rekrutimit për të siguruar një shërbim civil të qëndrueshëm, profesional dhe të bazuar në meritë, çka përbën edhe qëllimin e ligjit për nëpunësin civil, çmoj se duhet të shtohet në planin vjetor të punës së institucionit, zhvillimi i mbikëqyrjes së orientuar, parashikuar në nenin 14, gërma "c", të Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin Nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, me qëllim mbledhjen e informacionit në drejtim të funksionimit të procesit të rekrutimit në institucionet e administratës shtetërore, përgjatë periudhës tetor – dhjetor 2015.

Për këtë arsye,

në zbatim të Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin Nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenet 11/1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar,

VENDOSA:

1. Të përfshij në planin vjetor të punës së institucionit, të miratuar me Vendimin Nr. 19, datë 11.03.2015, "Për miratimin e planit vjetor të punës të institucionit", të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, mbikëqyrjen e orientuar, me qëllim mbledhjen e informacionit në drejtim të funksionimit të procesit të rekrutimit në institucionet e administratës shtetërore, përgjatë periudhës tetor – dhjetor 2015.
2. Grupi i mbikëqyrjes përbëhet nga Drejtori i Mbikëqyrjes, **Altin Shumeli**, i cili do të jetë në cilësinë e drejtuesit teknik të grupit dhe inspektorët **Saimir Muçmataj** dhe **Matilda Idrizaj**.
3. Anëtarët e grupit të mbikëqyrjes, së bashku ose veç e veç, kanë të drejtë të paraqiten dhe të kërkojnë dokumentacionin e nevojshëm, në të gjitha institucionet që nxjerrin akte administrative, apo kryejnë procedura të caktuara, që kanë lidhje me procesin e rekrutimit, të tilla si testimi me shkrim dhe intervista e strukturuar me gojë.
4. Me këtë vendim të njihet grupi i mbikëqyrjes dhe Departamenti i Administratës Publike.
5. Ngarkohet Drejtorja e Përgjithshme e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes për të zbatuar këtë vendim.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA